



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



“Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor”

UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

Nr. 7034 Prot., datë 23.12.2024

Nr. 3763 Prot., datë 23.12.2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi (“Marrëveshja”), lidhet sot më 23.12.2024, ndërmjet palëve të mëposhtme:

MINISTRI I SHTETIT PËR PUSHTETIN VENDOR, me adresë Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” godina nr.4, Tiranë, i përfaqësuar nga Ministri **Z. Arbjan MAZNIKU** (këtu e më poshtë, për efekt të kësaj marrëveshje “Ministria”).

dhe

UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS, (UBT)

Institucioni më i rëndësishëm i formimit Universitar, Pasuniversitar, Kërkimit Shkencor, Trajnimit dhe Ekstensionit në fushën e Bujqësisë dhe Mjedisit, përfaqësuar nga **Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU** në cilësinë e Autoritetit më të lartë akademik të Universitetit Bujqësor të Tiranës, si dhe përfaqësuesi ligjor i tij për çështjet akademike dhe protokollare me adresë “Kodër-Kamëz, Tiranë (këtu e më poshtë për efekt të kësaj marrëveshje “UBT”).

PREAMBULË:

Ndërmerret kjo iniciativë e përbashkët me vullnetin e mirë të institucionalizimit të bashkëpunimit në sferën e kërkimit shkencor që lidhen me interesat e njësisë të vetëqeverisjes vendore, Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Universitetit Bujqësor të Tiranës.

PËR SA MË SIPËR, duke marrë në konsideratë interesin e dyanshëm të palëve lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi sipas përcaktimeve sa vijon.

NENI 1

Qëllimi i Marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka për qëllim të standardizojë rregullat e bashkëpunimit ndërmjet **“Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor”** dhe **“Universitetit Bujqësor të Tiranës”** në fushën e kërkimit shkencor, ekspertizës, konsulencës dhe zhvillimit të qëndrueshëm të sektorëve, sipas fushës së veprimit.

NENI 2

OBJEKTIVAT E MARRËVESHJES

- a) Kjo marrëveshje ka për objektiv të saj krijimin e një platforme bashkëpunimi në kuadër të ofrimeve të shërbimeve në fushën e kërkimit shkencor, promovimin e saj dhe inovacionit;
- b) Rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor për të rritur cilësinë e kërkimit dhe për të përmirësuar politikat vendore;
- c) Zhvillimin e aktiviteteve kërkimore, realizimin e trajnimeve, projekteve, studimeve, konferencave ose tryezave të përbashkëta me pjesëmarrjen e stafit akademik, studentëve, shoqërisë civile dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore.

NENI 3

BAZA LIGJORE

Kjo marrëveshje mbështetet në ligjin nr.7850, datë 29.7.1994, “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, vendimin nr. 188, datë 13.3.2019 të Këshillit të Ministrave “Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre” i ndryshuar, vendimin nr.557, datë 4.10.2023 të Këshillit të Ministrave “Përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor” dhe në Statutin e Universitetit Bujqësor të Tiranës.

NENI 4

ANGAZHIMET E PALËVE

1. **Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor**, merr përsipër të angazhohet si më poshtë vijon:
 - a) Ministria ka të drejtë të kërkojë sipas nevojës shërbime me fonde buxhetore, si konsulenca, studime apo ekspertiza nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, sipas fushës së veprimit;
 - b) Të ofrojë asistencë për UBT në përshtatje të kërkimeve të realizuara me realitetin e nevojave të njësive të qeverisjes vendore, duke kontribuar në krijimin e standarteve dhe rregulloreve të reja;
 - c) Angazhohet të shkëmbejë njohuri dhe eksperiencë me ekspertët e UBT-së për të siguruar një lidhje më të ngushtë midis kërkimit dhe zbatimit;
 - d) Të miratojë protokollet e përbashkëta të punës për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;
 - e) Të caktojë personin përgjegjës për ndjekjen e ecursës së implementimit të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje;
2. **Universiteti Bujqësor i Tiranës**, merr përsipër të angazhohet si më poshtë vijon:
 - a) Të sigurojë ekspertizën, konsulencën dhe burimet njerëzore të nevojshme për realizimin e kërkimeve shkencore dhe studimeve;
 - b) Të angazhojë studentët, stafin akademik me qëllim dhënien e kontributit të tyre në zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta;
 - c) Të ofrojë shërbime cilësore sipas qëllimit të kësaj marrëveshjeje;
 - d) Të përcaktojë tarifat përkatëse me akte të brendshme për shërbimet e ofruara për Ministrinë kur mungojnë parashikimet ligjore që rregullojnë këtë fushë;
 - e) Të miratojë protokollet e përbashkëta të punës për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje; dhe
 - f) Të caktojë personin përgjegjës për ndjekjen e ecursës së implementimit të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

NENI 5

KOHËZGJATJA E MARRËVESHJES

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të saj dhe do të jetë e vlefshme për një afat kohor prej 1 (një) viti me të drejtë rinovimi pas përfundimit të tij.
2. Marrëveshja mund të zgjidhet edhe para afatit të përcaktuar sipas pikës 1 të këtij nenit, në rastet e mëposhtme:

- a. Në çdo kohë, me vullnet të përbashkët dhe pa pasoja për njëra – tjetrën, duke bërë njoftimin me shkrim 30 ditë para datës së vendosur për përfundimin e marrëveshjes;
- b. Në rast të mospërbushjes së angazhimeve nga cilado Palë të parashikuara në nenin 4, e cila nuk korrigjohet brenda një afati kohor prej 30 (tridhjetë) ditë nga momenti i njoftimit të mospërbushjes nga Pala tjetër, ose kur kjo mospërbushje nuk mund të korrigjohet; dhe
- c. Në rastet e ngjarjeve të forcës madhore, e cila zgjat për më shumë se 3 (tre) muaj dhe pasojat e të cilës nuk mund të rregullohen nga asnjëra Palë.

NENI 6

PERSONAT E KONTAKTIT

1. Palët angazhohen të mbajnë komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve të tyre në kuadër të kësaj Marrëveshjeje.
Si rregull, komunikimi kryhet në formë shkresore, por edhe në formatin e komunikimit elektronik.
2. Çdo njoftim që do t'i jepet një Pale dhe çdo komunikim tjetër në lidhje me këtë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të bëhet me shkrim. Në momentin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, Personat e Kontaktit janë si vijon:

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor:

Z. Ermal Elezi Drejtor i Përgjithshëm i AMVV

ermal.elezi@amvv.gov.al

+ 355 69 603 7859

Universiteti Bujqësor i Tiranës:

Prof.Asoc.Dr. Fatmir Guri

fatmurguri@ubt.gov.al

+355 68 403 0603

NENI 7

PAVARËSIA AKADEMIKE E UNIVERSITETIT

1. UBT gëzon pavarësi akademike në përcaktimin e fushave, metodologjive të hulumtimit, si dhe kritereve të brendshme akademike për realizimin e aktivitetit shkencor, studimor dhe këshillues që kryen në kuadër të kësaj Marrëveshjeje.
2. UBT ruan të drejtën për të refuzuar kërkesa nga Ministria në rastet kur ato bien ndesh me standardet akademike, parimet e etikës profesionale, ose misionin e institucionit.

3. Palët bien dakord që Ministria nuk do të ndërhyjë në procesin e brendshëm akademik, kriteret e kërkimit, apo rezultatet shkencore të prodhuara nga Universiteti.

NENI 8

PRONËSIA INTELEKTUALE DHE PUBLIKIMI I REZULTATEVE

1. Të gjitha produktet intelektuale (studime, raporte, analiza, të dhëna, materiale trajnimi) të hartuara nga Universiteti në kuadër të kësaj Marrëveshjeje mbeten pronë intelektuale e Universitetit, me përjashtim të rasteve ku palët bien dakord ndryshe me shkrim.
2. Universiteti gëzon të drejtën të publikojë rezultate të studimeve dhe kërkimeve të kryera në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, duke respektuar çdo detyrim ligjor ose kufizim të dakordësuar me Ministrinë, veçanërisht në lidhje me të dhënat konfidenciale ose sensitive.

NENI 9

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

1. Çdo mosmarrëveshje që mund të lind nga implementimi i kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet Palëve.
2. Të gjitha mosmarrëveshjet që nuk arrihen të zgjidhet me mirëkuptim të ndërsjelltë, do të zgjidhen nga gjykata kompetente në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 10

DISPOZITA TË NDRYSHME

1. Kjo Marrëveshje është hartuar me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve. Çdo ndryshim ose shtesë e saj do të jetë i vlefshëm vetëm nëse formulohet me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja Palët
2. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar palët angazhohen të ruajnë dhe të përpunojnë të dhënat personale në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.
3. Palët shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje.
4. Kjo Marrëveshje hartohet në 4 kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 kopje për secilën palë.

PËR

**“MINISTRINË E SHTETIT PËR
PUSHTETIN VENDOR”**

Z. Arbjan MAZNIKU



PËR

**“UNIVERSITETIN BUJQËSOR
TË TIRANËS”**

Prof.Dr Fatbardh SALLAKU

